

V E N D I M
Nr. 396, datë 27.7.2000

**PËR NJOHJEN E PERIUdhËS SË SIGURIMIT PËR EFEKT PENSIONI DHE AKSIDENTI
NË PUNË TË TË DËNUARVE ME BURGIM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtutës, të nenit 35, të ligjit nr.8328, datë 16.4.1998 dhe të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Për efekt të njohjes së periudhës së sigurimit për pension dhe aksident në punë, në pagën që u jepet personave të cilët punojnë gjatë kohës që janë të dënuar me burgim, do të llogaritet kontributi për sigurimet shoqërore në mbështetje të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, dhe të shtesave dhe ndryshimeve që i janë bërë këtij ligji.

2. Paga, për të cilën i dënuari do të sigurohet, nuk mund të jetë më e ulët se paga minimale e vitit përkatës, e cila caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Organet e administratës së repartit ku i dënuari kryen dënimin me burg do të llogarisin masën e kontributit nga paga që i jepet të dënuarit kur ai punon.

4. Kontributi për sigurime shoqërore, në bazë të pagës mujore që i takon të marrë i dënuari me burgim, do të llogaritet në masën 31.7 për qind për pension dhe 5 për qind për aksident pune. Pagesa e këtij kontributi do të realizohet duke zbritur 10 për qind nga paga bruto që merr i dënuari, ndërsa pjesa tjetër do të paguhet nga punëdhënësi në masën 21.7 për qind dhe 0.58 për qind të shumës bruto të listëpagesës.

5. Kontributi do të derdhet në emër të të dënuarit, në llogarinë e sigurimeve shoqërore të atij rrethi nën juridiksionin e të cilit ndohet repartit ku i dënuari kryen dënimin. Masa e pagesës dhe ndalesa e kontributit për pension pleqërie të pasqyrohen në listëpagesat–tip, të miratuara nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, të cilat, nëpërmjet bankës, depozitohen pranë organeve të sigurimeve shoqërore së bashku me urdhërxhirimin.

6. Ky vendim i shtrin efektet financiare duke filluar nga dat 1.1.1999.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta